

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Krijimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. është përshkruar në detaje në "Marrëveshjen për krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkëta", datë 19.01.2023, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkive Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë dhe Vau i Dejës. Kjo marrëveshje përbën edhe Aktin e Themelimit të shoqërisë pritëse, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.

Kjo shoqëri përfaqëson një subjekt me kompetenca të përbashkëta, siç parashikohet në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Transferimi i veprimtarive ekonomike është kryer në kuadrin e riorganizimit kombëtar të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, në përputhje me parashikimet në VKM nr. 302, datë 11.05.2022.

Marrëveshja për krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkëta, datë 19.01.2023, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkive Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë dhe Vau i Dejës, është dërguar me shkresë nga ana e njësive përkatëse për njoftimin e Prefektit të Qarkut Shkodër, përmes shkresës nr. prot. 1, datë 03.05.2023. Gjithashtu, Prefekti i Qarkut Shkodër ka konfirmuar ligjshmërinë e marrëveshjes përmes:

- shkresës nr. 249/1, datë 24.03.2023 drejtuar Këshillit Bashkiak Pukë,
- shkresës nr. 240/1, datë 24.03.2023 drejtuar Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz,
- shkresës nr. 207/1, datë 16.03.2023 drejtuar Këshillit Bashkiak Vau i Dejës, dhe
- shkresës nr. 259/11, datë 30.03.2023 drejtuar Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe.

Në cilësinë e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërive transferuese përkatëse, janë marrë vendime për të autorizuar administratorët përkatës të këtyre shoqërive, për të nënshkruar marrëveshjen noteriale të transferimit të veprimtarisë ekonomike, si dhe çdo akt tjetër të nevojshëm për të kompletuar procesin e transferimit. Vendimet janë marrë si më poshtë:

- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, nr. 06, datë 02.05.2023,
- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe, nr. 02, datë 02.05.2023,
- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Pukë, nr. 09, datë 02.05.2023,
- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, nr. 28, datë 02.05.2023.

Deri më datën e transferimit, që është 31.08.2023, në rajonin Shkodër, shërbimi është kryer nga shoqëritë dhe njësitet si më poshtë:

Emërtimi	NIPT
Bashkia Vau i Dejës	L67302001M
Bashkia Pukë	J6931030F
Bashkia Fushë-Arrëz	K19629304M
Bashkia Malësi e Madhe	K48420718C

Pas datës së transferimit, këto njësi ndërprejnë ushtrimin e aktivitetit të tyre kryesor dhe e drejta për ushtrimin e aktivitetit u transferua në favor të një shoqërie të re, të themeluar rishtas për këtë qëllim. Në vijim të këtij raporti, këto shoqëri do të referohen si "shoqëri transferuese".

Shoqëria e re e themeluar pati një kapital fillestar prej 10,000,000 lekësh, por me vendimin e Asamblesë së datës 10.07.2023 është miratuar rritja e kapitalit, dhe kapitali i ri është si më poshtë:

Emërtimi	NIPT
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA	M37819701O



(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM)

Aksionari	Pjesemarrja ne kapital ne%	Pjesemarrja ne kapital ne vlere
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	51%	19,727,000
Bashkia Shkodër	36,33%	14,053,000
Bashkia Fushë Arrëz	0,86%	333,000
Bashkia Malësi e Madhe	6,39%	2,470,000
Bashkia Pukë	2,19%	849,000
Bashkia Vau i Dejës	3,23%	1,248,000
TOTAL	100%	38,680,000

Siç është përmendur edhe në raportin paraardhës, lidhur me zmadhimin e kapitalit, gjejmë me vend të theksojmë se, sikurse parashikohet në Ligjin nr. 9901, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 168, pika 3, citojmë: "Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë."

Para zmadhimit të kapitalit, situata e aksioneve të nënshkruara dhe atyre të paguara ishte si më poshtë:

Aksionari perpara zmadhimit te kapitalit	Numri i aksioneve te nënshkruara cope	Vlera e aksioneve te nënshkruara Lek	Vlera e paguar Lek	Vlera e papaguar Lek
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	51,000	51,000,000	5,100,000	-
Bashkia Fushë Arrëz	3,330	333,000	-	333,000
Bashkia Malësi e Madhe	24,700	2,470,000	-	2,470,000
Bashkia Pukë	8,490	849,000	-	849,000
Bashkia Vau i Dejës	12,480	1,248,000	-	1,248,000
TOTAL	100,000	10,000,000	5,100,000	4,900,000

Vendimi i Asamblesë u publikua në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe, pavarësisht rrethanave të përmendura më sipër, zmadhimi i kapitalit u miratua rregullisht në përputhje me procedurat ligjore në fuqi. Pas zmadhimit të kapitalit, vlera e kapitalit të paguar dhe ajo e mbetur për secilin aksioner paraqitet si më poshtë:

Situata e aksionereve pas zmadhimit te kapitalit.				
Aksionari	Pjesemarrja ne kapital ne %	Pjesemarrja ne kapital ne vleren leke	Vlera e paguar Lek	Vlera e papaguar Lek
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	51.00%	19,727,000	12,600,000	7,127,000
Bashkia Shkodër	36.33%	14,053,000	-	14,053,000
Bashkia Fushë Arrëz	0.86%	333,000	-	333,000
Bashkia Malësi e Madhe	6.39%	2,470,000	-	2,470,000
Bashkia Pukë	2.19%	849,000	-	849,000
Bashkia Vau i Dejës	3.23%	1,248,000	-	1,248,000
TOTAL	100%	38,680,000	12,600,000	26,080,000

Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër përfshin transferimin në formë tërësore ose të pjesshme të pasurive dhe të drejtave, aktiveve dhe detyrimeve që lidhen me ushtrimin e këtyre veprimtarive. Diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve përfaqëson kontributin e secilës njësi në shoqërinë e krijuar rishtazi.

Kjo diferencë njihet si "emër i mirë" në shoqërinë pritëse dhe do të zhvlerësohet në përputhje me normat, rrethanat dhe parimet kontabël përkatëse. Vlera përkatëse e diferencës së aktiveve me detyrimet e transferuara paraqitet në pasqyrat financiare të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër dhe njihet si kontribut i kryer nga shoqëritë transferuese.



Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a
Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë paraqitur në Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM)

Në pasqyrat financiare të vitit 2023, vlera e kontributeve neto të transferuara nga:

- Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a.
- Ujësjetllës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a.
- Ujësjetllës-Kanalizime Pukë sh.a.
- Ujësjetllës-Kanalizime Vau i Dejës sh.a.
- Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.

në Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër, është në vlerën 1,843,763,750 lekë, e detajuar si më poshtë:

Njesia transferuese	Aktive te transferuara ne leke	Detyrime te transferuara ne lek	Vlera e kontributit shprehur ne lek
Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA	6,370,177,695	5,283,024,665	1,087,153,030
Ujësjetllës Kanalizime Fushë Arrëz SHA	28,728,953	12,401,534	16,327,419
Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe SHA	506,883,837	166,127,583	340,756,254
Ujësjetllës Kanalizime Pukë SHA	283,283,456	148,864,246	134,419,210
Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës SHA	434,230,664	169,122,827	265,107,837
TOTAL	7,623,304,605	5,779,540,855	1,843,763,750

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët dhe shitja e tij.
- Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve.
- Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura.
- Mirëmbajtja e sistemeve të ujrave të ndotura, si dhe e impjanteve të pastrimit të tyre.

Administrator të Shoqërisë janë Z. Besmir Lesha (i pezulluar) dhe Z. Ilir Baba. Adresa e Shoqërisë është: Lagja 3 Heronjtë, Rruga 3 Heronjtë, Shkodër.

Numri mesatar i punonjësve më 31 Dhjetor 2024 është 466 punonjës (31 Dhjetor 2023: 478 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Shoqëria përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në Shqipëri. Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

2.2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Bazat e matjes për secilin aktiv, detyrim, të ardhura ose shpenzime shpjegohen në detaje në seksionet vijuese.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Nderkombëtare të e Raportimit Financiar kërkon bërjen e disa çmuarjeve kontabël. Gjithashtu kërkohet që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë.

2.3 Monedha raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha informacionet financiare janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur deklarohet ndryshe.

3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar. Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë. Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023

Disa standarde të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive nga 1 janari 2023 dhe që janë miratuar nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Shoqërisë. Për këtë arsye informacioni shpjegues lidhur me këto Standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Shoqërisë. Në vitin aktual, Shoqëria ka aplikuar standarde të reja dhe të ndryshuara të kontabilitetit në bazë të SNRF të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BNSK) dhe të miratuara nga Bashkimi Evropian (BE) që kanë hyrë në fuqi dhe janë efektive në politikat kontabël që më 1 janar 2023. Miratimi i tyre nuk ka patur ndonjë ndikim material në përfundimet apo në shumat e raportuara në këto deklarata financiare.

- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimit (duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17 në qershor 2020 dhe dhjetor 2022). Shoqëria nuk ka asnjë kontratë që përmbush kriteret për tu klasifikuar si një kontratë sigurimi sipas SNRF 17.
- Ndryshimet në SNK 1 – Paraqitja e Pasqyrave Financiare – Materialiteti - Shoqëria ka adoptuar ndryshimet në SNK 1 për herë të parë në vitin aktual. Në lidhje me politikat kontabël në dhënien e informacioneve shpjeguese. Ndryshimi zëvendëson të gjitha rastet ku përmendet termi "politika të rëndësishme kontabël" me "informacion material të politikave kontabël". Informacioni i politikave kontabël është material nëse, në rast se shqyrtohet së bashku me informacionet e përfshira në pasqyrat financiare të Shoqërisë, mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme vendimet që përdoruesit primarë të pasqyrave financiare marrin në bazë të këtyre pasqyrave financiare. Paragrafët mbështetës të SNK 1 janë amenduar gjithashtu për të sqaruar se informacioni i politikave kontabël që ka të bëjë me transaksione, ngjarje apo kushte jomateriale nuk duhet të vendosen si informacione shpjeguese. Informacioni i politikave kontabël mund të jetë material për shkak të natyrës së transaksioneve të lidhura, ngjarjeve apo kushteve të tjera, edhe nëse shumat janë jomateriale. Megjithatë, jo të gjitha informacionet e politikave kontabël që kanë të bëjnë me transaksionet materiale, ngjarje apo kushte të tjera janë në vetvete materiale. Adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ka ndikim material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë.
- Ndryshimet në SNK 8 – Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet- Shoqëria ka adoptuar ndryshimet në SNK 8 për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet zëvendësojnë përkufizimin e një "ndryshimi në vlerësimet kontabël" me përkufizimin "vlerësimet kontabël". Sipas përkufizimit të ri, vlerësimet kontabël janë "shuma monetare në pasqyrat financiare që subjekt i pasigurisë së llogaritjes". Përkufizimi i një ndryshimi në vlerësimet kontabël është fshirë. Adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ka ndikim në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë.
- Ndryshimet në SNK 12- Tatimi i shtyrë i lidhur me Aktivet dhe Detyrimet nga një transaksion i vetëm – Shoqëria ka miratuar ndryshimet në SNK 12 për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet paraqesin një përjashtim të mëtejshëm nga përjashtimi fillestar i njohjes. Sipas ndryshimeve, një njësi ekonomike nuk zbaton përjashtimin nga njohja fillestare për transaksionet që sjellin diferenca të barabarta të përkohshme të tatueshme dhe të zbritshme. Në varësi të ligjit tatimor në fuqi, diferenca të përkohshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme mund të lindin në njohjen fillestare të një aktivi dhe detyrimi në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe nuk ndikon as në fitimin kontabël as fitimin e tatueshëm.

Pas ndryshimeve në SNK 12, një njësi ekonomike kërkohet të njohë aktivin dhe detyrimin tatimor të shtyrë, me njohjen e çdo aktivi-tatimor të shtyrë që i nënshtrohet kriterëve të rikuperueshmërisë në SNK 12. Adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ka ndikim në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë.



(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.2. Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Shoqëria planifikon ti aplikojë këto ndryshime në datat kur këto standarde do të jenë efektive.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri janë publikuar, por ende nuk janë efektive:

- Ndryshimi i SNRF 16 – Qiratë
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshime në SNK 1)
- Ndryshimet në SNK 1 – Paraqitja e pasqyrave financiare – Detyrimet afatgjata me premtime kufizuese

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, Drejtimi i ka bërë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e raportimit të pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve. Shpjegimi i supozimeve kyçe është përfshirë në seksionet përkatëse të shënimeve, aty ku janë përshkruar vlerësimet domethënëse.

Me përjashtim të ndonjë efekti që mund të rrjedhë nga ndryshimet në politikat kontabël të përshkruar në shënimin 3 të këtyre pasqyrave financiare, shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim.

4.1. Konvertimi i trasnaksioneve në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit emërtuara në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në Lek):

<u>Monedha</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
1 EUR	98,15	103,88
1 USD	93,04	93,94

4.2. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime, vlerësime dhe supozime nga ana e Drejtimit të Shoqërisë, të cilat mund të ndikojnë aplikimin e politikave dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësimet kontabël janë njohur për periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe për periudhat e ardhshme të ndikuara.



(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.3 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë hyrja bruto e përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, që linden gjatë rrjedhës së veprimtarive të zakonshme të një njësie ekonomike kur këto hyrje rezultojnë në rritje të kapitalit neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit e kapitalit neto. Të ardhurat përmbajnë vlerën e drejtë të vlerës së marrë ose të arkëtueshme për shitjen e mallrave dhe shërbimeve gjatë rrjedhës së zakonshme të veprimtarive të Shoqërisë. Të ardhurat paraqiten neto ndaj tatimit mbi vlerën e shtuar, kthimet, zbritjet dhe zbritjet dhe pasi eliminojnë shitjet Brenda Shoqërisë, nëse ka.

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ekzistojnë pasiguri e lartë në lidhje me kryerjen e pagesave dhe kostot e ndërlidhura.

Të ardhurat njihen nëse ekzistojnë mundësi për të realizuar flukset e ardhshme të parave dhe këto flukse mund të maten me besueshmëri.

4.4 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje pas përdorimit të shërbimit ose në datën e origjinës së tyre. Shpenzimet për garancitë njihen dhe ngarkohen ndaj provizionit shoqërues kur njihen të ardhurat përkatëse.

4.5 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë).

Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.



4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.5. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16) (vazhdim)

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

4.6. Përfitimet e punonjësve

Shoqëria është e detyruar nga legjislacioni aktual shqiptar të jape kontribute fikse në emër të punonjësve në një fond social të operuar nga Qeveria. Të gjitha pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato lidhen.

4.7. Toka, makineritë dhe pajisjet

Toka, makineritë dhe pajisjet paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar. Kostoja historike përfshin shpenzime që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aktivit.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me të do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tyre mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar c'regjistrohet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat e amortizimit të përdorura janë si më poshtë:

Asete të trupëzuara	%
Ndërtesa	5
instalime teknike të përgjithshme	20
Makineri e pajisje	20
Mjete transporti	20
Mobilje e orëndi	20
Kompjutera e sisteme informacioni	25

Vlerat e mbetur e aktiveve dhe jeta e dobishme rishikohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë raportimi. Kur vlera kontabël e një aktivi është më e madhe se vlera e parashikuar e rikuperueshme, ajo regjistrohet menjëherë në shumën e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet që vijnë nga nxjen-ja jashtë e aktiveve, pajisjeve dhe makinerive përcaktohen si diferenca midis të ardhurave të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të aktiveve dhe njihen në fitim ose humbje.

4.8. Aktive jo-materiale

Licencat e programeve kompjuterike të blera kapitalizohen mbi bazën e kostove të ndodhura për të siguruar dhe instaluar programin specifik. Këto kosto amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Amortizimi ngarkohet me 25% në metodën e vlerës së mbetur.

4.9. Instrumentet financiare

Aktivitet financiar dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet pale në provizionet korraaktuale të instrumenteve financiare dhe maten fillimisht me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit, përveç atyre që mbarten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes të cilat maten fillimisht në mënyrë të drejtë vlera dhe kostot e transaksionit janë njohur në fitim ose humbje.



(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.9. Instrumentet financiare (vazhdim)

4.9.1. Aktivet financiare

Shoqëria klasifikon aktivet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme: aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, huatë dhe të arkëtueshmet, aktivet financiare të mbajtura deri në maturim dhe aktivet financiare të disponueshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë bërë investimet. Drejtimi përcakton klasifikimin e investimeve të tij në njohjen fillestare dhe rivlerëson këtë në çdo datë raportimi.

a) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Kjo kategori ka dy nen-kategori: aktivet financiare të mbajtura për shitje dhe ato të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes. Aktivet financiare klasifikohen në këtë kategori nëse blihen kryesisht për qëllime të shitjes në një afat të shkurtër, nëse është pjesë e një portofoli të pasurive financiare në të cilat ka prova të marrjes së fitimit afatshkurtër. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

b) Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë kuotuar në një treg aktiv përveç atyre që Shoqëria synon të shesë në një afat të shkurtër ose që ajo ka përcaktuar si me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes. Huatë dhe të arkëtueshmet njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionin për zhvlerësim.

Një provizion për zhvlerësimin e huave dhe të arkëtueshme përcaktohet kur ekzistojnë prova objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e përcaktuara sipas kushteve të tyre.

c) Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim

Aktivete financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturime fikse, përveç atyre që plotësojnë p'erkufizimin e huave dhe të arkëtueshme, për të cilat drejtimi i Shogerise ka qëllimin dhe aftësinë pozitive për t'i mbajtur ato deri në maturim. Këto aktive njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionin për zhvlerësim nëse ka. Një provizion për zhvlerësimin e titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim përcaktohet kur ekzistojnë prova objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve të tyre origjinale. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

d) Aktive financiare të mbajtura për shitje

Aktivete financiare të disponueshme për shitje janë asete financiare jo-derivative që janë përcaktuar në këtë kategori ose nuk janë klasifikuar në ndonjë prej kategorive të tjera. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

e) Njohja fillestare dhe ç'registrimi

Blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt të aktive financiare njihen në datën e transaksionit - data në të cilën Shoqëria merr përsipër të blejë ose shesë aktivin. Aktivete financiare fillimisht njihen me vlerën e drejtë plus, në rastin e të gjitha aktiveve financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së tyre. Aktivete financiare të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes fillimisht njihen me vlerën e drejtë, dhe koston e transaksionit njihen në fitim ose humbje.

Pasuritë financiare ç'registrohen kur të drejtat për të marrë fluks parash prej tyre kanë skaduar ose ku ato janë transferuar dhe Shoqëria gjithashtu ka transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

f) Matja e mepasshme e aktiveve financiare

Aktivete financiare të mbajtura për shitje dhe aktivete financiare të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, eventualisht mbahen me vlerën e drejtë. Huatë dhe të arkëtueshme mbarten me koston të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parealizuara që vijnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë të "Aktiveve financiare me vlerë të drejtë përmes kategorisë së fitimit ose humbjes" përfshihen



(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.9. Instrumentet financiare (vazhdim)

4.9.1. Aktivet financiare (vazhdim)

f) Matja e mepashme e aktiveve financiare (vazhdim)

në fitimin ose humbjen në periudhën në të cilën ato lindin. Fitimet dhe humbjet e përealizuara që vijnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë jo monetare, të klasifikuara si të disponueshme për shitje, njihen në kapitalin neto. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si të disponueshme për shitje janë shitur ose zhvlerësuar, rregullimet e akumuluar të vlerës së drejtë përfshihen në fitim ose humbje si fitime / humbje të realizuara neto nga aktivet financiare.

Fitimet ose humbjet që vijnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë të kategorisë "aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes" janë paraqitur në fitimin ose humbjen brenda fitimeve neto nga vlera e drejtë në aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes në periudhën në të cilat ato lindin. Ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë monetare dhe jo-monetare të klasifikuara si në dispozicion për shitje njihen në kapitalin neto.

Interesi për letrat me vlerë të disponueshme për shitje të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si pjesë e të ardhurave të tjera. Dividentët në instrumentet e kapitalit të disponueshëm për shitje njihen në fitim ose humbje kur vendoset e drejta e Shoqërisë për të marrë pagesa. Vlerat e drejta të investimeve të kuotuar bazohen në çmimet e ofertave aktuale. Nëse tregu për një aktiv financiar nuk është aktiv, Shoqëria vendos vlerën e drejtë duke përdorur teknikën e vlerësimit. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve të kohëve të fundit të krahut, duke iu referuar instrumenteve të tjerë që janë në thelb të njëjta, analiza e rrjedhës së parave të zbritura, etj.

g) Detyrime financiare

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e pagueshme dhe detyrime të tjera. Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar nga kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së tyre. Detyrimet financiare më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

h) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar shumat e njohura dhe ka një qëllim për të shlyer në bazë neto, ose për të realizuar aktivin dhe shlyerjen e përgjegjësisë njëkohsisht.

4.10. Zhvlerësimi

4.10.1. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse provat objektive tregojnë se një ose më shumë ngjarje kanë efekte negative në rrjedhën e parave të parashikuara nga aktivi.


Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferenca midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të fuksit të parasë së parashikuar të zbritur me normë efektive të interesit.

